

ALBDESIGN PSP SH.P.K

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Së bashku me Raportin e Audituesit të pavarur

PËRMBAJTJA

	Faqe
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAT FINANCIARE	7 - 22

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe ortakun e Shoqërisë ALBDESIGN PSP SH.P.K

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **ALBDESIGN PSP SH.P.K**, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2019, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 2019, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Theksim çështje

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin 4 të pasqyrave financiare, i cili përshkruan vlerësimin e menaxhimit në lidhje me ndikimin aktual dhe potencial të pandemisë së COVID - 19 dhe të masave kufizuese të lidhura me kompaninë. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, goftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuiojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.



23 prill 2020

Luan Kamberi
Auditues ligjor

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2019

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	5	76,598,567	68,997,227
Llogari të arkëtueshme tregtare	6	68,331,260	105,698,354
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	7	55,479,579	71,169,987
Të tjera llogari të arkëtueshme	8	6,797,569	6,501,387
Inventari	9	3,576,437	4,192,168
Shpenzime të shtyra	10	14,605,100	2,354,374
Total aktive afatshkurtra		225,388,512	258,913,497
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	11	50,181,262	51,749,572
Pjesëmarrje në njësi të tjera	12	25	25
Total aktive afatgjatë		50,181,287	51,749,597
Total aktive		275,569,799	310,663,094
DETYRIME			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	13	190,170	18,593,125
Llogari të pagueshme tregtare	14	50,902,872	79,574,919
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	15	116,559,563	118,570,696
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	16	-	40,154
Detyrime tatimore	17	2,785,341	3,017,695
Të ardhurat e shtyra		3,716,645	3,333,333
Të tjera detyrime	18	427,803	1,492,412
Total detyrime afatshkurtra		174,582,394	224,622,334
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë	19	5,483,185	-
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	20	2,985,840	2,985,840
Total detyrime afatgjatë		8,469,025	2,985,840
Totali i detyrimeve		183,051,419	227,608,174
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar	21	70,000,000	70,000,000
Rezerva ligjore		499,880	10,000
Rezerva të tjera		12,555,040	3,047,330
Fitimi i ushtrimit		9,463,460	9,997,590
Total kapitali		92,518,380	83,054,920
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		275,569,799	310,663,094

Shënimet shpjeguese të faqeve 7 - 23 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	22	194,507,975	199,240,569
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	23	(273,215)	236,189
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(156,968,293)	(165,762,853)
1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	24	(143,211,333)	(152,928,817)
2) Të tjera shpenzime	25	(13,756,960)	(12,834,036)
Shpenzime të personelit	26	(17,004,596)	(14,881,449)
1) Paga dhe shpërblime		(14,616,720)	(12,793,017)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore		(2,387,876)	(2,088,432)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	11	(11,551,223)	(9,968,294)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	27	(396)	(1,123)
Të ardhura të tjera		-	-
(Shpenzime)/të ardhura financiare neto	28	2,086,082	2,633,704
(Shpenzime)/të ardhura interesi dhe			
1) (Shpenzime)/të ardhura të ngjashme neto		2,091,497	2,521,765
2) (Shpenzime)/të ardhura të tjera financiare neto		(5,415)	111,939
Fitimi/humbja para tatimit		10,796,334	11,496,743
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	29	(1,332,874)	(1,499,153)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(1,332,874)	(1,499,153)
Fitimi/humbja e vitit		9,463,460	9,997,590
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		9,463,460	9,997,590

Shënimet shpjeguese të faqeve 7 - 23 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Albdesign PSP sh.p.k

(Vlerat janë në Lek)


Pasqyra e ndryshimeve në Kapital

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	100,000	10,000	33,888,374	39,058,956	73,057,330
Fitimi / Humbja e vitit	-	-	-	9,997,590	9,997,590
Lëvizjet përmes kapitalit	69,900,000	-	(30,841,044)	(39,058,956)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	70,000,000	10,000	3,047,330	9,997,590	83,054,920
Fitimi / Humbja e vitit	-	-	-	9,463,460	9,463,460
Lëvizjet përmes kapitalit	-	489,880	9,507,710	(9,997,590)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	70,000,000	499,880	12,555,040	9,463,460	92,518,380

Shënimet shpjeguese të faqeve 7 - 23 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 janë aprovuar nga administratori më 25 mars 2020 dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:


Z. Kleant LAMI
Administrator

ALBDESIGN PSP

Rr. Çerçiz Topulli, 17 - Kashar, Tiranë
NIPT: L518190050


Mazars shpk
Hartues i Pasqyrave Financiare

 **MAZARS**
Rr. Emin Durraku, Pall 'Binjaket'.
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone : +355 42 27 80 15
www.mazars.al , info@mazars.al

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	9,463,460	9,997,590
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	182,382	619,082
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	-	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	11,551,223	9,968,294
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	40,510,593	(55,212,905)
Rënie/(rritje) në inventarë	615,731	(2,638,095)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(32,064,788)	35,113,315
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	427,803	146,434
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	30,686,404	(2,006,285)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata material	(9,982,912)	(22,033,545)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(9,982,912)	(22,033,545)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Hua të arkëtuara	(12,889,495)	18,479,058
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(12,889,495)	18,479,058
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	7,813,997	(5,560,772)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	68,997,227	75,152,492
<i>Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	(212,657)	(594,493)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	76,598,567	68,997,227

5

Shënimet shpjeguese të faqeve 7 – 23 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

“Albdesign PSP” sh.p.k (Shoqëria) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar pranë QKR me datë 19/06/2015 me NIPT L51819005Q në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2018 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 70,000,000 Lekë (shtatëdhjetë milion) i ndarë në 1 kuotë me vlerë nominale 70,000,000 lekë, me ortak të vetëm z. Elvis Sula.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është shitje shtypshkrime të ndryshme, punime grafike dhe dizenjime. Viti 2015 është viti i parë i aktivitetit të kompanisë. Aktiviteti i shoqërisë është parashikuar të jetë pa ndërprerje mbi 10 vjet.

Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga "Çerçiz Topulli", Objekti nr.17, Kashar, Tiranë.

Ajo është regjistruar në Degën e Tatimeve të rrethit Tiranë.

Administratori i shoqërisë është z. Kleant Lami.

Më 31 dhjetor 2019 shoqëria kishte 43 punonjës (2018: 42 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr. 25/2018, datë 10 maj 2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e Financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5 Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)**

Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%. Në të tilla raste, Shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2019	2018
EUR/LEK	121.77	123.42
USD/LEK	108.64	107.82
GBP/LEK	143.00	137.42

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përfaqësohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën fillestare.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyrën	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

3.11 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13 Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm.

4. Gjykimet dhe vlerësimet kritike të kontabilitetit

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijmësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

5. Mjete monetare

Gjëndja e mjeteve monetare në arkë dhe bankë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Mjete monetare në bankë	65,953,594	67,968,069
Llogari rrjedhëse	65,344,541	67,753,869
Fonde të ngurtësuar	609,053	214,200
Mjete monetare në arkë	10,644,973	1,029,158
	76,598,567	68,997,227

6. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Klientë	68,331,260	105,698,354
	68,331,260	105,698,354

7. Llogaritë të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të arkëtueshme tregtare	25,661,924	48,002,007
Të tjera të arkëtueshme	27,367,655	23,167,980
Dividend i arkëtueshëm Inform Albania	2,450,000	-
	55,479,579	71,169,987

8. Të tjera llogari të arkëtueshme

Të tjera llogari të arkëtueshme afatshkurtra, më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018, paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrime doganore	19,883	32,711
Të tjera kërkesa për arkëtim	1,474,403	1,125,729
Garanci për tendera	1,013,978	-
Taksa gjyqësore	118,360	102,760
Tatim fitimi	3,907,313	5,240,187
Paradhënie ndaj punonjësve	263,632	-
	<u>6,797,569</u>	<u>6,501,387</u>

9. Inventari

Gjëndja e inventarit më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Lëndë e parë	2,176,950	3,846,902
Mallra për rishitje	1,399,487	345,266
	<u>3,576,437</u>	<u>4,192,168</u>

10. Shpenzime të shtyra

Shpenzime të shtyra, më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018, paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime të shtyra	9,754,439	1,134,155
Parapagime për furnitorët	4,850,661	1,220,219
	<u>14,605,100</u>	<u>2,354,374</u>

11. Aktivet afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	Makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Mobilje dhe orendi	Kompjuter	Të tjera	Totali
Kosto						
Gjendja më 31 dhjetor 2017	41,351,376	6,069,885	694,152	1,134,855	1,234,080	50,484,348
Shtesa	21,664,882	-	50,800	118,219	199,644	22,033,545
Gjëndja më 31 dhjetor 2018	63,016,258	6,069,885	744,952	1,253,074	1,433,724	72,517,893
Shtesa	1,078,188	8,178,568	577,656	86,088	346,594	10,267,093
Pakësime	-	581,280	-	-	-	581,280
Gjëndja më 31 dhjetor 2019	64,094,446	13,667,173	1,322,608	1,339,162	1,780,318	82,203,706
Amortizimi						
Gjendja më 31 dhjetor 2017	7,933,393	2,075,123	236,260	327,354	227,897	10,800,027
Amortizimi i vitit	8,621,388	798,948	102,397	226,357	219,204	9,968,294
Gjëndja më 31 dhjetor 2018	16,554,781	2,874,071	338,657	553,711	447,101	20,768,321
Amortizimi i vitit	9,456,025	1,560,021	92,970	211,102	231,105	11,551,223
Pakësime	-	297,099	-	-	-	297,099
Gjëndja më 31 dhjetor 2019	26,010,806	4,136,993	431,627	764,813	678,206	32,022,445
Vlera neto kontabël						
Gjendja më 31 dhjetor 2017	33,417,983	3,994,762	457,892	807,501	1,006,183	39,684,321
Gjendja më 31 dhjetor 2018	46,461,477	3,195,814	406,295	699,363	986,623	51,749,572
Gjendja më 31 dhjetor 2019	38,083,640	9,530,180	890,981	574,349	1,102,112	50,181,262

12. Pjesëmarrje në njësi të tjera

Shoqëria "Albdesign PSP" ka blere 24.5% kuota të kapitalit të Shoqërisë " Inform Albania sipas kontratës për Kalimin e Kuotave datë 20.04.2017, me vlerë 24.5 lekë.

13. Hua afatshkurtra

Huatë afatshkurtra, më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018, paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Overdraft Karta Kreditit Raiffeisen	184,170	80,125
Overdraft Raiffeisen Bank	6,000	18,513,000
	<u>190,170</u>	<u>18,593,125</u>

14. Llogari të pagueshme tregtare

Llogari të pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Furnitorë vendas	50,345,157	78,333,093
Furnitorë të huaj	557,715	1,241,826
	<u>50,902,872</u>	<u>79,574,919</u>

15. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Të pagueshme tregtare	93,859,437	95,770,630
Të pagueshme të tjera	22,700,126	22,800,066
	<u>116,559,563</u>	<u>118,570,696</u>

16. Të pagueshme për shpenzime të konstatuara

Të pagueshme për shpenzime të konstatuara, më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018, paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Furnitorë për fatura të pa mbërritura	-	40,154
	<u>-</u>	<u>40,154</u>

17. Detyrime tatimore

Detyrime tatimore më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	350,941	295,120
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi	36,171	27,950
Tatim në burim	1,087,162	1,132,624
TVSH për t'u paguar	1,311,067	1,562,001
	<u>2,785,341</u>	<u>3,017,695</u>

18. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera, të cilat paraqesin detyrimet ndaj pononjësve dhe të tjera detyrime, më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrime ndaj personelit	427,803	146,434
Të tjera detyrime	-	1,345,978
	<u>427,803</u>	<u>1,492,412</u>

19. Hua afatgjatë

Huatë afatgjatë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Qira financiare Raiffeisen Bank	1,358,800	-
Qira financiare Intesa San Paolo Bank	4,124,385	-
	<u>5,483,185</u>	<u>-</u>

20. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura paraqesin financimet e ortakut dhe më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Finacim Elvis Sula	2,985,840	2,985,840
	<u>2,985,840</u>	<u>2,985,840</u>

21. Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 70,000,000 lekë, i ndarë në 1 kuotë me vlerë nominale 70,000,000 lekë.

22. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga shitja e produkteve të gatshëm	161,531,855	131,819,285
Të ardhura nga kryerja e shërbimeve	11,953,884	22,814,994
Të ardhura nga shitja e mallrave	19,341,786	43,062,858
Të ardhura nga shitja e materialeve	-	3,832
Të ardhura nga komisionet nga shitja e aboneve	1,680,450	1,539,600
	194,507,975	199,240,569

Tabela më poshtë përfaqëson rakordimin e të ardhurave me deklaratimet mujore të TVSH-së.

Rakordimi ndërmjet të ardhurave në PASH dhe atyre të deklaruara në FDP	Për vitin e mbyllur më dhjetor 2019
Shitje total të deklaruara në FDP-në e TVSH-së	219,148,615
Ndryshim i gjendjes së parapagimeve	(383,315)
Vlera e shitjes së aboneve të transportit urban	(23,827,000)
Shitje të deklaruara në FDP që janë të ardhura në PASH	194,938,300
Shitje produkte të gatshme	161,531,855
Shitje mallrash e materialesh	19,341,786
Shitje shërbime	13,634,334
Të ardhura nga shitja AAM	430,325
Të ardhura të deklaruara në PASH që janë deklaruar shitje në FDP	194,938,300
Fitim nga këmbimet valutore	460,618
Të ardhura nga interesat	456
Të ardhurat të tjera financiare	152,676
Të ardhura nga dividendi	2,450,000
Total të ardhura të deklaruara në FDP-në e Tatim Fitimit	198,002,050

23. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe të ardhura të tjera jo-kryesore dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga shitja e AQT	430,325	-
Vlera Kontabël e Aktiveve të Shitura	(284,181)	-
Fitime nga këmbimete valutore	429,685	1,643,484
Humbje nga këmbimet valutore	(849,044)	(1,407,295)
	(273,215)	236,189

24. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Lënda e parë e parë dhe materiale të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Kosto e lëndëve të para e materialeve	104,673,602	86,295,819
Qira trualli dhe ndërtese	12,050,600	12,310,723
Kosto e mallrave	8,442,480	23,182,268
Nënkontraktorë	6,841,029	21,689,818
Mirëmbajtje dhe riparime makineritë dhe fabrika	5,820,699	4,015,669
Energji elektrike, ujë	4,473,579	4,225,034
Shërbime e shpenzime të tjera	474,007	140,208
Qira të tjera	435,337	1,069,278
	143,211,333	152,928,817

25. Të tjera shpenzime

Të tjera shpenzime për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime udhëtimi e dieta	3,193,202	2,601,671
Shërbim auditimi dhe konsulenca ekonomike	1,478,355	1,648,299
Të tjera	1,441,559	1,283,029
Liçenca printimi	1,205,962	124,001
Shërbim ruajtje objekti	1,149,260	1,101,947
Shërbime postare	995,742	1,146,968
Prime të sigurimit	750,256	718,111
Shpenzime për kontrolle teknike e çertifikime	685,352	594,764
Konsulenca juridike	500,000	676,010
Komisione bankare	424,578	439,057
Shpenzime panairi	412,201	-
Taksa të ndryshme	293,628	231,872
Kancelari	263,506	424,309
Shpenzime administrative noteriale	220,402	204,101
Shpenzime trainimi dhe rekrutimi	139,934	79,825
Shpenzime për pritje	133,268	155,850
Leje mjedisi	125,000	130,000
Shpenzime për pjesëmerja në tender	114,703	673,164
Shpenzime anëtarësim në dhomat e tregëtisë	76,515	112,265
Shpenzime përkthimi	74,300	71,000
Shpenzime për mirëmbajtje programe kompjuterike	38,112	138,718
Uji pijshëm	31,125	13,875
Shërbim inxhinierik	10,000	-
Sponsorizim	-	265,200
	13,756,960	12,834,036

26. Shpenzime të personelit

Shpenzime të personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime për paga dhe shpërblime	14,616,720	12,793,017
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	2,387,876	2,088,432
	17,004,596	14,881,449

27. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzime për gjoba dhe penalitete për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Gjoba dhe penalitete	396	1,123
	396	1,123

28. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime për interesa	(489,157)	(4,972)
Të ardhura nga interesat	456	4,869
Të ardhura nga Dividentët nga investimet në pjesëmarrje	2,450,000	2,521,868
Shpenzime të tjera financiare	(58,168)	-
Të ardhura të tjera financiare	152,676	136,527
Humbje nga këmbimet valutore nga huatë	(657)	(669,843)
Fitime nga këmbimet valutore nga huatë	30,932	645,255
	2,086,082	2,633,704

29. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Fitimi para tatimit	10,796,334	11,496,743
Shpenzime të panjohura (si më poshtë)	539,494	1,019,476
Shpenzime pritje dhe dhurata	117,238	150,048
Tatim në burim i paguar për furnitorin	255,053	267,497
Penalitet, gjoba e dëmshpërblime	396	1,123
Shpenzime të viteve të kaluara	-	10,225
Shpenzime pa faturë të rregullt tatimore	166,807	590,583
Të ardhura të patatueshme (si më poshtë)	(2,450,000)	(2,521,868)
Të ardhura nga Dividentet nga investimet nëpjesëmarrje	(2,450,000)	(2,521,868)
Fitimi para tatimit (përfshire shpenzimet e panjohura dhe te ardhurat e pa tatueshme)	8,885,829	9,994,351
Tatim fitimi 15%	1,332,874	1,499,153
Fitimi i vitit	9,463,460	9,997,590

29. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin (Vazhdim)

Të ardhurat e marra nga Dividentet nga Investimet në Pjesëmarrje nuk merren në konsideratë në përcaktimin e fitimit të tatueshëm, sipas nenit 26 të Ligjit 8438 “Për Tatimin mbi të ardhurat”, dividendët dhe ndarjet e fitimit, kur ato shpërndahen nga shoqëritë e ortakëritë rezidente dhe shoqëritë jorezidente të huaja, që janë subjekte të tatimit mbi fitimin, pavarësisht nga kuota e pjesëmarrjes, në vlerë ose në numër, të kapitalit aksionar, të së drejtës së votës apo të pjesëmarrjes në kapitalin fillestar apo aksionar të përfituesit

30. Palët e lidhura

Këto përfaqësojnë transaksionet me palët e lidhura, si njësitë e kontrolluara, të kontrolluara bashkarisht ose kanë një ndikim të konsiderueshëm nga palët e tilla. Politikat e tarifimit dhe kushtet e këtyre transaksioneve janë aprovuar nga manaxhimi.

Balancat me palët e lidhura të përfshira në pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

Bilanci kontabël	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të arketueshme nga palët e lidhura		
Agi Kons	33,397,882	39,104,362
Albdesign	17,807,011	16,661,389
Inform Albania	4,274,686	15,404,236
	55,479,579	71,169,987
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura		
Agi Kons	70,256	70,256
Albdesign	114,865,128	118,410,547
Inform Albania	16,175	89,893
Orkaku Elvis Sula	4,593,844	2,985,840
	119,545,403	121,556,536

Balancat me palët e lidhura të përfshira në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve		
Shitje palëve të lidhura		
Albdesign	22,409,600	11,228,245
Inform Albania	14,358,369	21,050,242
Agi Kons	1,510,178	2,082,672
	38,278,147	34,361,159
Blerje nga palët e lidhura		
Albdesign	7,237,413	36,721,900
Inform Albania	1,502,133	1,868,168
Agi Kons	-	34,775
E.Sula	8,275,030	-
	17,014,576	38,624,843

31. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2019, Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

32. Ngjarje pas datës së bilancit

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit e deklaroi koronavirusin (COVID-19) një pandemi. Ndërsa situata është ende duke u zhvilluar në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Menaxhimi pret që zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, të ndikohen nga situata. Impakti financiar do të njihet nga Kompania gjatë vitit 2020. Menaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndërmarrë të gjitha hapat e mundshëm për të lehtësuar çdo efekt. Menaxhimi e konsideron këtë pandemi si një ngjarje që nuk rregullohet pas datës së raportimit dhe e ka shpalosur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Efektet mbi bazën e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare janë shpalosur në shënimin 4 "gjykimet dhe vlerësimet kritike të kontabilitetit" të këtyre pasqyrave financiare.

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit, e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.